



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e konform nenit 4 paragrafi 1, pika 1.5 lidhur me nenin 14, paragrafi 7, të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M
Për miratimin e Strategjia për Informim dhe Komunikim

Neni 1

MIRATOHET- Strategjia për Informim dhe Komunikim për Komunën e Suharekës për periudhën 2022-2025 (në tekstin e mëtejme SIK).

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendim është Strategjia për Informim dhe Komunikim për Komunën e Suharekës për periudhën 2022-2025, me numër të protokollit 01-Nr-016-33092 e datës 03.06.2022, e përgatitur nga grupi punues i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorisë dhe zyra për marrëdhënie me publikun e Komunës e Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N S Ë N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI